
GROSS DOMESTIC PRODUCT AND DEVELOPMENT IN KOSOVO'S FOREIGN TRADE

Nuhi Kadolli

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, nuazka@hotmail.com

Ibush Luzha

Prishtina, Kosovo, ibushluzha@hotmail.com

Burim Morina

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, bmorina7@hotmail.com

Abstract: The paper reflects the economic transactions of Kosovo with other countries of the world. As this paper belongs to the field of finance, the research focuses on Kosovo's foreign trade including Kosovo's trade exchanges and trading partners in the period 2008-2015. The main objective of the paper focuses on the review and analysis of Kosovo's trade transactions with other countries, including the period 2008-2015. The performance of Kosovo's foreign trade is also reviewed, as well as the analysis of the performance of exports and imports with EU countries, countries in the region and other countries.

In addition to other macroeconomic indicators, foreign trade also expresses the level of economic development of the respective country, which is expressed through the value and structure of imported and exported goods.

Kosovo after the war of 1999, oriented market economy in foreign trade is dominated by imports with low level of exports resulting in high trade deficit. The paper analyzes Kosovo's foreign trade and Kosovo's trading partners.

Keywords: gross product, foreign trade

BRUTO PRODUKTI VENDOR DHE ZHVILLIMET NË TREGTINË E JASHTME TË KOSOVËS

Nuhi Kadolli

Kolegji "Biznesi" Prishtinë – Kosovë, nuazka@hotmail.com

Ibush Luzha

ibushluzha@hotmail.com

Burim Morina

Kolegji "Biznesi" Prishtinë – Kosovë, bmorina7@hotmail.com

Abstrakt: Në kuadër të punimit pasqyrohen transaksionet ekonomike të Kosovës me vendet tjera të botës. Meqenëse ky punim i përket fushës së financave, hulumtimi përqendrohet në tregtinë e jashtme të Kosovës duke përfshirë shkëmbimet tregtare dhe partnerët tregtarë të Kosovës në periudhën 2008-2015. Objektivi kryesor i punimit përqendrohet në shqyrtimin dhe analizimin e transaksioneve tregtare të Kosovës me vendet tjera duke përfshirë periudhën 2008-2015. Po ashtu shqyrtohet ecuria e tregtisë së jashtme të Kosovës si dhe analizimi i ecurisë së eksportit dhe importit me vendet e BE-së, vendet e rajonit dhe vendet tjera.

Përveç treguesve të tjerë makroekonomik po ashtu edhe tregtia e jashtme shpreh nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit përkatës që shprehet nëpërmjet vlerës dhe strukturës së mallrave të importuara dhe të eksportuara.

Kosova pas luftës së vitit 1999, me orientim ka ekonomia e tregut në tregtinë e jashtme është e dominuar nga importi me nivel të ulët të eksportit duke rezultuar me deficit të lartë tregtar. Në kuadër të punimit analizohet tregtia e jashtme e Kosovës dhe partnerët tregtarë të Kosovës.

Fjalët kyqe: bruto produkti, tregtisë së jashtme

1. HYRJE

Kosova është e përkushtuar për liberalizimin e tregtisë. Mirëpo, tregtia e jashtme e Kosovës është e dominuar nga importet ndërsa eksporti është në nivel të ulët duke rezultuar kështu në deficit të lartë tregtarë.

Në kuadër të punimit pasqyrohen transaksionet ekonomike të Kosovës me vendet tjera të botës. Meqenëse ky punim i përket fushës së financave, hulumtimi përqendrohet në tregtinë e jashtme të Kosovës duke përfshirë shkëmbimet tregtare dhe partnerët tregtarë të Kosovës në periudhën 2008-2015. Objektivi kryesor i punimit përqendrohet në shqyrtimin dhe analizimin e transaksioneve tregtare të Kosovës me vendet tjera duke përfshirë periudhën 2008-

2015. Po ashtu shqyrtohet ecuria e tregtisë së jashtme të Kosovës si dhe analizimi i ecurisë së eksportit dhe importit me vendet e BE-së, vendet e rajonit dhe vendet tjera.

Përveç treguesve të tjerë makroekonomik po ashtu edhe tregtia e jashtme shpreh nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit përkatës që shprehet nëpërmjet vlerës dhe strukturës së mallrave të importuara dhe të eksportuara.

2. BRUTO PRODUKTI VENDOR DHE ZHVILLIMET NË TREGTINË E JASHTME TË KOSOVËS

Në analizat empirike makroekonomike treguesi më i rëndësishëm është Bruto Produkti Vendor - BPV (Gross Domestic Product – GDP). Treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), përmes të cilit pasqyrohet performanca e ekonomisë së një vendi në një periudhë të caktuar kohore. Bruto produkti vendor (BPV) është rezultat i punës (aktiviteteve ekonomike) të ekonomisë së një vendi në sferën e prodhimit dhe përbëhet nga të gjitha të mirat materiale të prodhuara dhe shërbimet e ndryshme që ajo i kryen brenda një viti, apo periudhe të caktuar kohore.¹⁵ Andaj, sipas kriterit prodhues, BPV paraqet vlerën e produkteve finale dhe të shërbimeve të prodhuara në ekonominë e një vendi në periudhë të dhënë kohore. Prodhimi i brendshëm bruto (PBB) është vlera e tregut e të gjithë mallrave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara brenda një vendi në një periudhë të dhënë kohe.¹⁶

Kosova pas përfundimit të luftës në vitin 1999, gjendej në fazën e tranzicionit, ku proceset ekonomike kishin tendencë negative, kështu që rezultatet tregojnë se zhvillimi ekonomik përballet me shumë sfida.


Si tregues makroekonomik më i përgjithshëm përmes të cilit shprehet dinamika e zhvillimit ekonomik merret Bruto Produkti Vendor (BPV).

Tabela 1: Ecuria e Bruto Produktit Vendor (BPV) në periudhën e viteve 2008-2014.

Vitet	Bruto Produkti Vendor (milion euro)	Bruto Produkti Vendor për banorë (në euro)	BPV- Norma reale e rritjes
2008	3.616,1	2,258	4.5
2009	4.022,4	2,329	3.6
2010	4.204,3	2,480	3.3
2011	4.594,6	2,672	4.4
2012	4.949,8	2,799	2.8
2013	5.232,8	2,935	3.4
2014	5.391,7	3.084	1.2

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, Bruto Produkti Vendor në qasjen e shpenzimeve 2008-2014, Prishtinë 2015, fq 9.

Grafiku 1: Norma reale e rritjes së BPV-së në periudhën 2008-2014.



¹⁵ Dr. Musa Limani, Makroekonomia, Prishtinë, 2013, fq 73.

¹⁶ N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, Makroekonomia, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, UET Press 2012, fq 38.

Nga grafiku, mbi ecurinë e BPV-së, në periudhën e viteve 2008-2014, shihet se vlera e BPV-së ka pasur trend rritës, duke u rritur nga 3.616,1 milionë euro sa ishte në vitin 2008, në 5.391,7 milionë euro në vitin 2014. Ndërsa, BPV për banor u rritë nga 2,258 euro sa ishte në vitin 2008, në 3,084 euro në vitin 2014. Në periudhën 2008-2014, BPV-ja e përgjithshme edhe përkundër trendit rritës, ku në vitin 2008 norma e shtimit mesatar vjetor ishte 4.5%, duke pasur rënie të lehtë në vitet në vijim, ndërsa në vitin 2014 norma reale e rritjes ishte 1.2%. Nga kjo mund të konstatojmë se: Ekonomia e Kosovës me një dinamikë të këtyllë të zhvillimit nuk ka pasur ndryshime esenciale sa i përket treguesve ekonomikë në periudhën përkatëse.

Në vazhdim po prezentojmë normat e shtimit të GDP-së të Kosovës në raport me vendet e Ballkanit Perëndimor 2008-2015.

vijim pasqyrohet trendi i BPV-së në vendet e rajonit në periudhën 2008-2015.

Tabela 2: Rritja reale vjetore e BPV-së në Kosovë dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, në periudhën 2008-2015.

Vendet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Kosova	4.5	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4	1.2	3.0
Maqedonia	5.0	-0.9	2.9	2.8	-0.5	2.7	3.8	3.2
Serbia	3.8	-3.5	1.0	1.6	-1.0	2.6	-1.8	0.5
Shqipëria	7.5	3.4	3.5	2.3	1.6	1.4	1.9	2.7
Mali i Zi	6.9	-5.7	2.5	3.2	-2.5	3.3	1.5	3.2
Bosnja e Hercegovina	5.6	-2.7	0.8	1.0	-1.2	2.5	1.1	2.1

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Raporti i zhvillimeve makroekonomike, Numër 4, Prishtinë 2016, fq 18.

Kosova gjatë vitit 2015 u karakterizua me normë pozitive të rritjes ekonomike, mirëpo sikurse vendet e rajonit, edhe ekonomia e Kosovës u karakterizua me normë të ulët të rritjes. Në bazë të të dhënave në tabelën nr.2 dhe grafikun nr.4, në vitin 2015 krahasuar me periudhën paraprake, në kuadër të gjitha vendeve të rajonit vërehet një trend më i lartë i rritjes së BPV-së. Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë gjatë vitit 2014, sipas vlerësimeve ishte 1.2%, e cila në vitin 2015 ishte 3.0%.

Meqë, Bruto Prodhimi Vendor (BPV) matë prodhimin e brendshëm, vlera e të gjitha shpenzimeve të importit zbritet nga të gjitha shpenzimet duke përdorë formulën:¹⁷

$$BPV = KF + FKB + (E-I)$$

Bruto produkti vendor (BPV) sipas qasjes së shpenzimeve është shuma e të gjitha shpenzimeve finale të mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime ndahen në tri grupe kryesore : a) Konsumi final, b) Formimi i kapitalit bruto dhe c) Neto eksporti.

Në një ekonomi të hapur një pjesë e produktit shitet brenda vendit, ndërsa një pjesë shitet jashtë vendit, pra eksportohet. Shpenzimet në një ekonomi të hapur ndahen në katër komponentë:¹⁸

- C, Konsumi i brendshëm i mallrave dhe shërbimeve;
- I, Investimi në mallra dhe shërbime brenda vendit;
- G, Shpenzimet e qeverisë;
- NX, Neto eksporti.

Në pikëpamje matematikore BPV ose Y shprehet:

$$Y=C+I+G\pm NX$$

Nga kjo, shuma e tre komponentëve të parë, C+I+G, përbën shpenzimin e brendshëm për mallra dhe shërbime të vendit. Komponenti i katërtë NX, eksporti neto përbën diferencën ndërmjet eksporteve dhe importeve (NX=EX-IM). Shuma e shpenzimeve të brendshme për mallra dhe shërbime të huaja përbën shpenzimet për importe IM, ndërsa shpenzimi i huaj për mallra dhe shërbime të vendit, pra eksporti EX. Nga kjo kemi: $Y=C+I+G+EX-IM$.

¹⁷ Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Statistikat Ekonomike, Bruto Produkti Vendor 2008-2014, Prishtinë 2015, fq 14.

¹⁸ Dr. Mimoza Koka, Makroekonomia, Tiranë, 2014, fq 329.

Ky ekuacion tregon se në një ekonomi të hapur, shpenzimet e brendshme nuk janë të njëjta me produktin e brendshëm për mallra dhe shërbime. Në rast se produkti i tejkalon shpenzimet e brendshme vendi eksporton dhe diferenca eksporte neto është pozitive. Në rast se produkti është më i ulët se shpenzimet e brendshme vendi importon dhe diferenca eksporti neto është negative.

Në tabelën në vijim pasqyrohet struktura e BPV-së sipas shpenzimeve në Kosovë, në periudhën 2008-2014, shprehur në përqindje.

Tabela 3: Struktura e BPV sipas shpenzimeve, në periudhën 2008-2014.

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
BPV me çmime aktuale	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0
Shpenzimet e konsumit final	107,5	103,7	102,6	103,3	105,2	104,0	105,2
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	89,9	86,7	85,6	86,0	88,1	87,3	88,5
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	17,0	16,4	16,4	16,7	16,6	16,2	16,4
Qeveria e Kosovës	9,2	10,0	11,3	12,0	12,4	12,4	13,0
Donatorët (pagat)	7,8	6,4	5,1	4,6	4,3	3,9	3,4
Të punësuar të huaj	5,1	4,4	3,6	3,2	3,0	2,7	2,3
Të punësuar vendor	2,7	2,0	1,6	1,4	1,3	1,2	1,0
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	0,6	0,6	0,6	0,6	0,4	0,4	0,3
Formimi i bruto kapitalit	31,1	31,1	33,0	33,9	29,0	27,6	25,8
Formimi i bruto kapitalit fiks	27,1	27,8	29,6	30,7	26,0	24,8	23,2
Ndryshimet në inventar	4,0	3,4	3,4	3,2	2,9	2,8	2,5
Eksporti neto	-38,6	-34,9	-35,6	-37,2	-34,1	-31,6	-30,9
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	15,7	17,1	19,9	19,6	18,2	17,4	19,6
Eksporti i mallrave	5,6	4,4	6,9	6,7	5,7	5,7	5,8
Eksporti i shërbimeve	10,1	12,7	13,0	12,8	12,6	11,7	13,8
Importi i mallrave dhe shërbimeve	54,3	52,0	55,5	56,8	52,4	49,0	50,5
Importi i mallrave (FOB)	48,1	44,9	46,7	49,5	46,7	43,1	42,8
Importi i shërbimeve	6,2	7,0	8,8	7,3	5,7	5,9	7,7

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës, Statistikat Ekonomike, Bruto Produkti Vendor 2008-2014, Prishtinë 2015, fq 10.

Kosovën që nga periudha e pasluftës në tregtinë e jashtme e karakterizon deficiti tregtar ku dominon vlera e importeve krahasuar me eksportet. Vështruar tabelën dhe grafikun, pjesmarrja e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në BPV-në në vitin 2008 ishte 15.7%, importet e mallrave dhe shërbimeve kishin pjesmarrje prej 54.3% në BPV-në, ndërsa eksportet neto në raport me BPV-në ishin -38.6%.

$(NX=EX-IM =15.7-54.3= -38.6\%)$.

Ndërsa në vitin 2014 pjesmarrja e eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në BPV-në ishte 19.6%, importet e mallrave dhe shërbimeve kishin pjesmarrje prej 50.5% në BPV-në, ndërsa eksportet neto në raport me BPV-në ishin -30.9%.

$(NX=EX-IM =19.6-50.5= -30.9\%)$.

Në periudhën 2008-2014, vërehet rënien e eksporteve neto në raport me BPV-në, nga minus – 38.6%, sa ishte në vitin 2008, në minus -30.9% eksportet neto/BPV-në, në vitin 2014.

3. KUPTIMI I TREGTISË SË JASHTME

Siç dihet, një vend, pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit të forcave prodhuese, nuk mund t'i prodhojë të gjitha të mirat materiale dhe të ofrojë shërbime të ndryshme që janë të nevojshme për plotësimin e nevojave të qytetarëve të tij. Andaj, me qëllim të sigurimit të të mirave materiale dhe shërbimeve të ndryshme qytetarëve të vet, një vend hyn në marrëdhënie ekonomike me vendet e tjera të botës. Sistemi ekonomik i mbështetur në tregun orientohet në lidhjet

e ngushta midis ekonomive të vendeve të ndryshme. Këto lidhje realizohen ndërmjet dy kanaleve kryesore:¹⁹ Kanali tregtar dhe kanali financiar. Një ekonomi e hapur bashkëvepron me ekonomitë e tjera në dy mënyra: ajo blen e shet mallra dhe shërbime në tregjet botërore të produkteve dhe blen e shet asete kapitale si aksione dhe obligacione në tregjet financiare të botës.²⁰

Tregtia e jashtme ka rëndësi të madhe, qoftë për ekonominë kombëtare apo atë ndërkombëtare. Tregtia e jashtme mundëson zgjerimin e qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve nga tregu i brendshëm në tregun botëror, dhe në këtë mënyrë mundëson zhvillim më të hovshëm të ekonomisë kombëtare. Po ashtu, tregtia e jashtme mundëson konkurrencën në tregun e brendshëm, që ndikon në ngritjen e cilësisë dhe uljen e çmimeve të prodhuesve vendorë. Po ashtu, tregtia e jashtme ndikon edhe në ndryshimin e shijes së konsumatorëve, për të mirat materiale që nuk prodhohen, apo prodhohen në sasi të caktuara, përkatësisht në sasi jo të mjaftueshme. Ndërsa, nga aspekti i ekonomisë ndërkombëtare, tregtia e jashtme ndikon në përmirësimin dhe alokimin e faktorëve të prodhimit dhe në këtë mënyrë ndikon në zhvillimin e ekonomisë botërore. Tregtia e jashtme ka rëndësi të madhe, veçmas për vendet jo mjaft të zhvilluara, të cilave tregu i brendshëm dhe niveli i ulët i zhvillimit të forcave prodhuese nuk u mundëson të prodhojnë të mira materiale dhe të ofrojnë shërbime si për kah sasia, cilësia, asortimenti etj., të cilat u nevojiten dhe i kërkojnë qytetarët e këtyre vendeve.

Andaj, në kushtet bashkëkohore të ekonomizimit as që mund të mendohet zhvillimi ekonomik i një vendi si dhe ekonomia botërore pa marrëdhënie ekonomike të ndërsjella ndërmjet shteteve. Tregtia e jashtme merret me marrëdhëniet ekonomike të një vendi me vendet e tjera të botës në fushën e qarkullimit të mallrave dhe të shërbimeve, përkatësisht në shitjen (eksportin) dhe në blerjen (importin) e tyre.²¹ Nga aspekti makroekonomik tregtia e jashtme, marrë globalisht, mund të definohet si këmbim mallrash dhe shërbimesh të ndryshme të një vendi me vendet e tjera të botës, e cila në vete ngërthen dy komponentë kryesore:²²

- a) eksportin dhe
- b) importin.

Eksportet janë mallra dhe shërbime të prodhuara në vend të cilat shiten jashtë vendit dhe **importet** janë mallra dhe shërbime të prodhuara jashtë të cilat shiten brenda vendit.²³ Me fjalë tjera, tregtia e jashtme përfshin të gjitha transaksionet ekonomike të vendit përkatës me vendet e tjera të botës.

Në pamundësi që një vend t'i prodhojë të gjitha të mirat materiale dhe t'u ofrojë shërbime finale, për plotësimin e nevojave të popullatës së vet, hyn në marrëdhënie ekonomike me vendet e tjera të botës. Andaj, pa marrë parasysh nivelin e zhvillimit të forcave prodhuese dhe sistemin ekonomik-shoqëror, të gjitha vendet e botës zhvillojnë marrëdhënie ekonomike ndërkombëtare.

3.1.Faktorët që ndikojnë në tregtinë e jashtme

Në kushtet bashkëkohore shtetet hyjnë në marrëdhënie ekonomike në mes veti, pasi nuk mund të mendohet zhvillimi ekonomik i një vendi si dhe ekonomia botërore pa marrëdhënie ekonomike të ndërsjella ndërmjet shteteve. Tregtia e lirë i lejon ekonomitë për t'u specializuar në atë që ato bëjnë më së miri, duke i bërë banorët e të gjithë vendeve të jenë në pozitë më të mirë.²⁴ Kufizimet e tregtisë bien ndesh me këto dobi nga tregtia dhe kështu, reduktojnë mirëqenien e përgjithshme ekonomike.

Faktorë që mund të ndikojnë mbi eksportet, importet dhe eksportet neto të një vendi, këta faktorë përfshijnë sa vijon:²⁵

- Shijet e konsumatorëve për mallra vendase dhe të huaja;
- Çmimet e mallrave në vend dhe jashtë;
- Kurset e këmbimit me të cilat njerëzit mund ta përdorin monedhën vendase për të blerë monedha të huaja;
- Të ardhurat e konsumatorëve në vend dhe jashtë;
- Kostoja e transportit të mallrave nga vendi në vend;
- Politikat e qeverisë në drejtim të tregtisë ndërkombëtare.

¹⁹Po aty, fq 327.

²⁰ N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, Makroekonomia, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, UET Press 2012, fq 262.

²¹ Dr.Musa Limani, Makroekonomia, Prishtinë, 2013, fq 250.

²² Po aty, fq 250.

²³ N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, Makroekonomia. Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, Tiranë, UET Press 2012, fq 262.

²⁴ N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, Makroekonomia, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, Tiranë, UET Press 2012, fq 306.

²⁵ Po aty, fq 263.

Sa i përket eksportit, ekzistojnë faktorë të ndryshëm që ndikojnë në vëllimin e eksportit të mallrave, e që janë:

- çmimi i mallrave që eksportohen;
- masat për stimulimin e eksportit;
- rritja në tregun nacional;
- shijet e konsumatorëve në vendet eksportuese etj.

Padyshim se faktori kryesor që ndikon në eksportin e mallrave të një vendi është koncepti i përparësive komperative. Sipas këtij koncepti, ekonomia e një vendi tenton të eksportojë ato mallra, për prodhimin e të cilave është produktive ndaj prodhuesve të jashtëm, përkatësisht në tregun botëror.

Duke u bazuar në konceptin komperativ, një vend tenton të importojë ato të mira materiale që ka mangësi kooperative, d.m.th. që prodhimtaria e tyre nuk është efikase në ekonominë vendore. Shpesh, ka të mira materiale, të cilat janë më të lira të importohen nga vendet e tjera, sesa të prodhohen në ekonominë nacionale, për shkak të diferencës së madhe në shpenzimet prodhuese. Në këtë kuadër mund të themi se, eksporti dhe importi i mallrave dhe shërbimeve është një domosdoshmëri që kushtëzohet nga një varg faktorësh.²⁶

Kushtet e ndryshme të prodhimit.- Kushtet e prodhimit, ku përfshihen burimet natyrore, toka, kapitali, teknologjia etj., janë të ndryshme në vende të ndryshme, prandaj sasia, llojshmëria, cilësia e mallrave dhe shërbimeve, që prodhojnë vende të ndryshme nuk janë të njëjta. Resurset natyrore, përkatësisht lëndet e para që paraqesin parakushte dhe kushte të zhvillimit ekonomik, në pikëpamje gjeografike janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë nëpër vende të botës.²⁷ Kjo e bën të domosdoshëm këmbimin midis vendeve të ndryshme. Përparimi teknologjik gjithashtu ka ushqyer tregtinë ndërkombëtare duke ndryshuar llojet e mallrave që prodhojnë ekonominë.²⁸ Kur lëndët e para masive (si çeliku) dhe mallrat që prishen (si ushqimet) ishin një pjesë e madhe e prodhimit botëror, transportimi i mallrave shpesh ishte i kushtueshëm dhe ndonjëherë i pamundur. Në të kundërt, mallrat e prodhuara me teknologji moderne shpesh janë të lehtë dhe të lehta për t'u transportuar. Artikujt elektronikë të konsumit, për shembull, kanë peshë të ulët për çdo euro të vlerës, gjë që i bën ata të prodhohen në një vend dhe të shiten në një tjetër.

Ekonomizimet e shkallës.- Në shumë firma dhe degë të ndryshme, me rritjen e madhësisë së tyre vihet re rënia e kostos për njësi. Kjo dukuri quhet ekonomizim i shkallës.²⁹ Në shumë vende të botës ekzistojnë forma dhe degë të ndryshme, të cilat për shkak të madhësisë së tyre prodhuese realizojnë të ardhura të larta, apo kanë shpenzime të ulëta për njësi të prodhimit. Parë në aspektin ndërkombëtar, ato vende të cilat kanë fituar një pozicion superior në prodhimin e një produkti të caktuar kanë avantazhin e ekonomizimeve të shkallës. Prandaj ato specializohen në prodhimin e këtij produkti duke e eksportuar në vende që nuk kanë pozicion dhe që do t'u duhej të zgjeronin shumë madhësinë e prodhimit për të përfutur nga ekonomizimet e shkallës, gjë që do të kërkonte investime të mëdha.

Ndryshimet në shije.- Konsiderohet faktor që kushtëzon tregtinë e jashtme edhe elementi i preferencave në të mira materiale. Edhe në qoftë se kushtet e prodhimit do të ishin të njëjta për secilin vend, përsëri do të ishte e leverdishme të eksportohej dhe të importohej, përderisa shijet ndryshojnë nga një vend në një vend tjetër.

Arsyeja kryesore që qëndron në themel të faktorëve të mësipërm, e bën të domosdoshme tregtinë ndërkombëtare, është një nga parimet më themelore të ekonomisë, që njihet si parimi i avantazhit krahasues. Ky parim kushtëzon këmbimin e të mirave dhe shërbimeve midis individëve brenda vendit dhe midis vendeve të ndryshme dhe buron nga ndarja shoqërore e punës, që çon në rritjen e rendimentit të saj. Thelbi i avantazhit të krahasuar qëndron në pohimin që çdo vend mund të përfitojë nga tregtia me vendet e tjera, edhe në qoftë se nuk gëzon asnjë avantazh absolut. Mjafton që çmimi relativ (kostoja oportune) i mallit të eksportuar të jetë më i ulët se ai i mallit të importuar. Avantazhi absolut shpreh aftësinë e një vendi për të prodhuar, me të njëjtat burime, një sasi më të madhe produkti sesa vendet e tjera. Avantazhi krahasues përfaqëson një ligj, sipas të cilit një vend mund të specializohet në prodhimin dhe eksportin e atyre mallrave që mund t'i prodhojë me kosto relativisht më të ulët dhe të importojë ato mallra që mund t'i prodhojë me kosto relativisht më të lartë. Avantazhi krahasues llogaritet duke u mbështetur në koston oportune të secilit produkt. Ky parim tregon pse vendet e ndryshme të botës specializohen për prodhimin e produkteve të caktuara. Thelbi i këtij parimi qëndron në faktin se përfitimet nga tregtia e jashtme nuk qëndrojnë vetëm në përparësit absolute, por edhe në ato relative. Faktorë të tjerë të cilët ndikojnë janë edhe ndryshimet e kursit të këmbimit, marrëveshjet e ndryshme dhe rregullat ligjore mbi tatimet dhe kufizimit tregëtare, barrierat jo tarifore si mjedisore, shëndetësore etj.

²⁶ Dr. Mimoza Koka, Makroekonomia, Tiranë, 2014, fq 333.

²⁷ Dr.Musa Limani, Makroekonomia, Prishtinë, 2013, fq 261.

²⁸ N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, Makroekonomia, Përkthet: Artan Meci, Jorgji Qirjako, Tiranë, UET Press 2012, fq 264.

²⁹ Dr. Mimoza Koka, Makroekonomia, Tiranë, 2014, fq 334.

4. POLITIKA E TREGTISË SË JASHTME E KOSOVËS

4.1. Zhvillimet në tregtinë e jashtme të Kosovës

Në ekonominë e sotme moderne flitet shumë për tregti të lirë dhe procese liberalizuese, pavarësisht nga kjo, vendet përfitojnë nga tregtia në dy aspekte kryesore:

- Nga mundësia e blerjes së produkteve në tregun botëror me çmime më të ulta se në tregun e brendshëm;
- Nga eksporti i produkteve, për prodhimin e të cilave përdoren inpute, të cilat vendi i zotëron me shumicë dhe më lirë se në vendet e tjera.

Duke marr për bazë se sektori i tregtisë së jashtme ka një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik, politika tregtare është një nga instrumentet kryesore të politikës së përgjithshme ekonomike. Liberalizimi tregtar është esencial në ndërtimin e një ekonomie të hapur dhe për forcimin e konkurrencës së ekonomisë vendore për t'u përballur me importin në tregun vendor dhe për të përmirësuar performancën e eksportuesve. Kosova është një ekonomi e vogël, e hapur dhe gëzon një regjim liberal tregtar.³⁰ Kosova në vazhdimësi ka shprehur përkushtimin për liberalizimin e tregtisë. Me qëllim të zhvillimit dhe fuqizimit të marrëdhënieve në fushën e bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, duke i'u përmbajtur parimeve të ekonomisë së tregut, Kosova para anëtarësimit në CEFTA, ka nënshkruar marrëveshje bilaterale të tregtisë së lirë, me Shqipërinë 01.10.2003, Maqedoninë 03.08. 2005, Kroacinë 01.11.2006 dhe Bosnjën e Hercegovinën 12.12.2006. Këto marrëveshje u avancuan dhe u unifikuan në kuadër të CEFTA-së, pasi të gjitha këto vende u bënë anëtarë të kësaj marrëveshjeje multilaterale. Më 6 Prill 2006, në Samitin e Kryeministrave të shteteve të Evropës Juglindore, në Bukuresht është miratuar deklarata e përbashkët mbi zgjerimin e CEFTA-së me Shqipërinë, Bosnje e Hercegovinën, Moldavinë, Serbinë, Malin e Zi dhe UNMIK-un në emër të Kosovës. Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) është nënshkruar më 19.12.2006, në të cilën përfshihen këto vende:³¹ Rumania, Bullgaria, Maqedonia, Serbia, Kosova, Mali i Zi, Shqipëria, Kroacia dhe Bosnjë Hercegovina. Kosova është anëtarësuar në Marrëveshjen e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) në vitin 2007. Qëllimi kryesor i CEFTA-së ishte krijimi i kushteve më të volitshme të këmbimit të lirë të mallrave, kapitalit, njerëzve dhe të shërbimeve ndërmjet vendeve anëtare. Nga dhjetori 2008, Kosova gëzon trajtim preferencial nën Sistemin e Përgjithshëm të Preferencave të Shteteve të Bashkuara – një program që mundëson plasimin e produkteve kosovare në tregun e ShBA-ve pa detyrime doganore. Po ashtu, Kosova përfiton nga Masat Autonome Tregtare të BE-së, kjo korrespondon me trajtimin preferencial i cili mundëson qasje pa taksa doganore në tregun e BE-së. Marrëveshja për Stabilizim Asocim (MSA) e nënshkruar më 27 tetor 2015, mes Republikës së Kosovës në njërin anë, dhe Bashkimit Evropian në anën tjetër, përbëhet nga 10 kapituj që mbulojnë aspektet politike dhe ekonomike të procesit integruar.

Politika Tregtare e Kosovës është kryesisht e bazuar në parimet e tregtisë së lirë, me fokus të veçantë në promovimin e eksportit. Një politikë tregtare është një politikë e qeverisë, e cila ndikon drejtpërdrejt në sasinë e mallrave dhe shërbimeve që eksporton ose importon një vend.³² Politika tregtare merr formë të ndryshme. Një politikë e zakonshme tregtare është një tarifë, një taksë mbi mallrat e importuara. Një tjetër është një kuotë e importit, një kufi mbi sasinë e një malli që mund të prodhohet jashtë vendit dhe mund të shitet në vend. Me politikë të tregtisë së jashtme kuptojmë një sërë masash me të cilat pushtetmbajtësit (qeveria) ndikojnë në qarkullimin (këmbimin) e mallrave dhe të shërbimeve me vendet e tjera të botës.³³ Këtu hyjnë rregullativa (infrastruktura juridike) të ndryshme juridike e ekonomike me të cilat rregullohen transaksionet ekonomike të vendit përkatës me ekonominë e vendeve të tjera të botës.

Me anë të masave dhe instrumenteve të politikës së tregtisë së jashtme shteti mund të ndikojë në eksport dhe në import. Me anë të masave që i ndërmerr shteti mbrohet dhe nxitet zhvillimi ekonomik i vendit. Kosova nga periudha e pasluftës, në mungesë të strategjisë zhvillimore, kurse politika tregtare ishte rrjedhim i politikës së përgjithshme ekonomike që janë reflektuar në nivelin e zhvillimit ekonomik dhe në vëllimin dhe strukturën e tregtisë së jashtme, ku dominon importi i mallrave dhe shërbimeve në krahasim me eksportin.

4.2. Roli dhe ndikimi i politikës fiskale në tregtinë e jashtme

Sikurse edhe treguesit e tjerë makroekonomik, po ashtu edhe këmbimi ndërkombëtar shpreh nivelin e zhvillimit të forcave prodhuese të vendit përkatës, që shprehet përmes vlerës dhe strukturës së mallrave të importuara dhe të eksportuara. Në këmbimin ndërkombëtar në mes të shteteve, tatimi ka një ndikim mjaft të madh në ecuritë që zhvillohen në sferën e këmbimit të tregtisë së jashtme. Në përgjithësi, rezultate të shumta tregojnë se tregtia kontribuon në përmirësimin e rritjes ekonomike. Megjithatë, nëse tregtia nuk është e kombinuar me politika

³⁰ Programi për Reforma në Ekonomi, Prishtinë, 2016, fq 17.

³¹ Dr. Musa Limani, Integrimet Ekonomike Evropiane, Prishtinë, 2008, fq 134.

³² N.Gregory Mankiw dhe Mark P. Taylor, Makroekonomia, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, Tiranë, UET Press 2012, fq 303.

³³ Dr.Musa Limani, Makroekonomia, Prishtinë, 2013, fq 254.

adekuate për të balancuar importet kundrejt eksporteve, ajo mund të gjenerojë defiçite të bilancit tregtar dhe të bilancit të pagesave, duke krijuar në këtë mënyrë shkak për ngadalësim ose përkeqësim në rritjen e të ardhurës reale. Prandaj, tatimi konsiderohet një nga instrumentet e politikës fiskale mjaftë i rëndësishëm përmes të cilit ndikohet në procesin e këmbimit ndërkombëtar. Ndikimi i tatimit në këmbimin ndërkombëtar varet prej gjendjes dhe qëllimit të ekonomisë kombëtare. Tatimet indirekte janë tatime të bartshme në çmimin e mallrave dhe shërbimeve, kështu që ndikimi i tatimit në këmbimin ndërkombëtar vjen në shprehje përmes efektit të tij në çmimin e mallrave dhe shërbimeve gjatë eksportit dhe importit.

Aktualisht, ekonomia e Kosovës dhe zhvillimi i saj në kuadër të sektorit privat mbështetet kryesisht nga Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme-NVM-të, kryesisht të shtrirë aktivitetin e tyre në veprimtari shërbyese e shumë pak në atë prodhues. Duke pasur parasysh nivelin e ulët zhvillimor në vend, nuk duhet të vazhdohet të mbahet orientimi i politikës fiskale në funksion të rritjes së të hyrave buxhetore dhe mos aplikimi i masave lehtësuese fiskale ndaj aktivitetit ekonomik.

Kosova aplikon një sistem tatimor të thjeshtë me norma tatimore ndër më të ultat në rajon, po ashtu në vazhdimësi përmes reformave tatimore ka ndryshuar normat tatimore, vlen të ceket në vitin 2009, duke ulur normat tatimore në tatimin në të ardhurat personale nga 0, 5, 10 20% në 0, 4, 8, 10%, ndërsa nga 01. Shtatori 2015, ndryshimet tatimore veçmas në TVSh-në duke aplikuar përveç normës standarde të TVSh-së edhe normën e reduktuar të TVSh-së. Ndryshimet tatimore në TVSh-në që filluan të aplikohen në Kosovë që nga Shtatori 2015, përfshijnë ndryshimin e normave të TVSh-së si vijon:³⁴

- TVSh-ja ngarkohet me normën standarde prej tetëmbëdhjetë përqind (18%).
- Norma e reduktuar në TVSh-në llogaritet dhe paguhet prej tetë përqind (8%) për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe importit të tyre, si në vijim:
 - Furnizimi me ujë, përveç ujit të ambalazhuar;
 - Furnizimi me energji elektrike, përfshirë shërbimet e transmisionit dhe distribuimit, me ngrohje qendrore, mbledhjen e hedhurinave dhe trajtimin e mbeturinave tjera;
 - Drithërat sikurse janë elbi, misri, varietetet e misrit, tërshëra, thekra, orizi dhe gruri;
 - Prodhimet e bëra prej drithërave për qëllim të konsumimit njerëzor, sikurse janë mielli, brumërat, buka dhe prodhime të ngjashme;
 - Vajrat për gatim të bërë nga drithërat apo farërat vajore për përdorim në gatim për konsumim njerëzor;
 - Qumështi dhe produktet e qumështit me qëllim për konsumim njerëzor;
 - Kripa e përshtatshme për konsum njerëzor;
 - Vezët për konsum;
 - Librat shkollore dhe publikimet serike;
 - Furnizimi duke përfshirë huadhënien e librave nga bibliotekat, përfshirë broshurat, fletëpalosjet dhe materialet e ngjashme të shtypura, librat me fotografi për fëmijë, librat për vizatim dhe ngjyrosje, librat e muzikës në formë të shtypur apo të dorëshkrimit, hartat dhe grafiqet hidrografike dhe të ngjashme;
 - Pajisjet e teknologjisë së informacionit;
 - Furnizimi i barnave, produkteve farmaceutike, instrumenteve dhe aparateve mjekësore dhe kirurgjike;
 - Pajisjet mjekësore, autoambulancat, ndihmat dhe aparatet tjera mjekësore me qëllim që të lehtësojnë ose trajtojnë paaftësinë për shfrytëzim ekskluziv të të paafteve, duke përfshirë riparimin e këtyre mallrave dhe furnizimin e ulëseve të fëmijëve për vetura.

Në këtë kuadër ndryshimet tatimore që kanë të bëjnë me TVSh-në përfshijnë uljen e normës së TVSh-së në produkte dhe shërbime bazike nga 16% në 8%, rritjen e normës së TVSh-së në produkte dhe shërbime tjera nga 16% në 18%, si dhe uljen e pragut të TVSh-së për biznese nga 50,000 në 30,000 euro. Kosova është duke aplikuar shkallë tatimore shumë konkurruese krahasuar me vendet e rajonit. Kosova aplikon një politikë fiskale të favorshme në kontekstin e politikës tregtare, pasi eksportet janë të liruara nga ngarkesat tatimore. Lidhur me këtë, sistemi tatimor është i favorshëm për aktivitetet e eksportit.³⁵

³⁴ Ligji, Nr.05/L-037, Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar, neni 26, Prishtinë, 2015, fq 23.

³⁵ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Politika tregtare e Kosovës, Prishtinë, 2009, fq 19.

Tabela 4: Instrumentet dhe tarifet në tregtinë e jashtme.

Instrumentet dhe tarifet në tregtinë e jashtme	Eksport	Import
TVSh-ja	0%	8%
		18%
Taksa doganore	0%	10%

Burimi: Ligji, Nr.05/L-037, Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar, Prishtinë, 2015, fq 23. Ligji Nr. 04/L-163, Për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, Prishtinë, 2014, fq 3.

Eksportet janë të liruara nga TVSH-ja dhe taksa doganore.³⁶ Me fjalë të tjera, përmes politikës fiskale të favorshme bëhet përpjekje në nxitjen e prodhimit vendor dhe stimulimin e eksportit të vendit. Kosova aplikon në importe taksën doganore prej 10%, TVSh-në me normë tatimor 8% për produkte bazike dhe 18% për produkte tjera. Po ashtu, mallrat si duhani, kafeja, pijet alkoolike dhe joalkoolike, vera, birra, derivatet dhe produktet e ngjashme, automjetet, ngarkohen me akcizë. Duke pasur parasysh strukturën e deficitit tregtar, ndryshimet në politikën tatimore në vitin 2015, si ulja e pragut të TVSH-së, përshtetja e TVSH-së, lirimi për linjat e prodhimit dhe makinerisë që ndërliken me prodhimin si dhe për pajisjet e Teknologjisë Informative, duke bashkëvepruar me atë të subvencioneve për sektorin e bujqësisë të orientuara ka stimulimi i prodhimit vendor do të mundësohet të stimulohet eksporti kosovar dhe zëvendësimit të importit.

5. PËRFUNDIMI

Në kuadër të punimit master janë shtjelluar veçoritë në tregtinë e jashtme, mardhëniet tregtare të Kosovës, ecuria dhe struktura eksportit dhe importit si dhe partnerët tregtarë të Kosovës në periudhën 2008-2015.

Kosova në periudhën e pas luftës iu qasë ndërtimit të ekonomisë së hapur të tregut. Në këmbimin tregtar të Kosovës është evident bilanci negativ tregtar ku dominon importi në krahasim me eksportin. Pra, Kosova që nga periudha e pasluftës është tejet e varur nga importi dhe trendët tregojnë se në periudhën afatëshkurtër është vështirë të priten ndryshime të mëdha. Në tregtinë e jashtme, tregu i BE-së dhe vendet e rajonit mbeten partnerët kryesor tregtar të Kosovës, ndërsa viteve të fundit vërehet rritje e shkëmbimeve tregtare të Kosovës me Turqinë dhe Indinë. Tregtinë e jashtme të Kosovës që nga periudha e pasluftës e karakterizon varësia nga importi dhe niveli i ulët i eksporteve.

LITERATURA

- Agjencia e Statistikave të Kosovës (2016). statistikat e tregtisë së jashtme 2015
 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2015). statistikat e tregtisë së jashtme 2014
 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2014). statistikat e tregtisë së jashtme 2013
 Agjencia e statistikave e Kosovës (2014). Kosova në shifra 2013
 Berisha, S. (2002). Ekonomia Ndërkombëtare, Prishtinë
 Berisha, S. (1998). Mardhëniet ekonomike ndërkombëtare, Prishtinë
 Koka, M. (2014). Makroekonomia, Tiranë
 Limani, M. (2013). Makroekonomia, Prishtinë
 Limani, M. (2008). Integrimet Ekonomike Evropiane, Prishtinë
 Limani, M. (2002). Hyrje në ekonomi, Prishtinë
 Mankiw, N.G. & Taylor, M. P. (2012). Makroekonomia, Përktheu: Artan Meci, Jorgji Qirjako, UET Press
 Manqellari, A., Haderi, S., Kule, D., & Qirici, S. (2007). Hyrje në ekonomi, Tiranë
 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, (2009). Politika tregtare e Kosovës, Prishtinë,

³⁶ Ligji Nr. 04/L-163, Për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, Prishtinë, 2014.